



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “RSM Company” Sh.P.K. të datës 08.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e **pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “RSM Company” Sh.P.K. e datës 08.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-24-3595-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “RSM Company” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “RSM Company” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 08.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Intervenime infrastrukturore - ndarja zonale në 6 zona në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimi 616-24-3595-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, perkatesisht tek stafi profesional nder te tjera kerkohet: • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës, min.3 vite, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; Konsiderojme qe kerkesa e fundit qe pervoja e punes te deshmohet permes kontratave te punedhenesit eshte kerkese e tepert dhe absurde pasi qe nje i punesuar nuk ka asnje arsye logjike ti ruaje dhe ti kete ne dispozicion kontratat e punedhenesve te meparshem, dhe rrjedhimisht kjo kerkese pervec kesaj arsye eshte edhe diskriminuese dhe favorizon kompanite qe mund te kene te punesuar per kohe te gjate stafin e kerkuar ne DT. Pra kerkojme nga AK-ja qe te rishikoje kete kerkese diskriminuese dhe favorizuese dhe te largoje komplet".

Pretendimi nr. 2 - "Ne Dosje te Tenderit, pika 9.1 & 9.2, Nenpika e fundit kerkohet: Për te gjitha diplomat- kualifikimet e arritura (persona te diplomuar) ne vendet jashtë Republikës se Kosovës kërkohet qe diploma e tyre te jenë të nostrifikuar ne Republikën e Kosovës. Edhe kjo kerkese eshte diskriminuese dhe favorizuese per kompani te caktuara, per arsye se qe nga data e publikimit te njoftimit per kontrate dhe deri ne daten e dorezimit te ofertave nuk eshte as 1 muaj i plote, dhe e dijme te gjithë se sa kohe merr procesi i nostrifikimit te diplomave te huaja ne Rep. e Kosoves dhe kur dihet se shume nga inxhinieret e kerkuar kane kryer shkollimin jashte Rep. se Kosoves per arsye te ndryshme. Edhe per kete pike kerkojme nga AK-ja qe ta largoje komplet nga lista e kerkesave te DT, sepse eshte e pamundur te kryhet procesi i nostrifikimit te diplomave per kete periudhe te shkurter".

Pretendimi nr. 3 - "Ne Dosje te Tenderit, eshte kerkuar qe te ofrohet qe kompania te kete Bazen e asfaltit, betonit dhe gurethyesit ose te kete kontrate valide, dhe si deshmi te paraqitet: • Duhet të dëshmohet pronësia e bazës së prodhimit të asfaltit/gurethyesit/betonit apo duhet kontratë furnizimi me një bazë të prodhimit të asfaltit/gurethyesit/betonit për këtë kontratë, leja e bazës së asfaltit/gurethyesit/betonit duhet të jetë me validitet të paku deri në përfundim të kontratës. Edhe kjo kerkese eshte tejet favorizuese per kompani te caktuar, njekohesisht edhe redukon deri ne maksimum konkurrencen mes kompanive ne kete rast, pasi qe e dijme te gjithë qe Bordi i KPMM-se nuk eshte aktiv per me shume se 2 vite, dhe per kete arsye kerkesa ne kete rast eshte tejet absurde dhe diskriminuese, pasi qe eshte e logjikshme qe Licenca/leja te jete valide se paku deri ne momentin e dorezimit te ofertave".

Sa i përket pretendimit nr. 1 ku parashtruesi thotë se është kërkesë diskriminuese që përvoja e punës të dëshmohet sipas kontratave paraprake të punës, është kërkesë e pabazuar pasi që parashtruesi nuk ka parashtruar argumente përmes të cilave do të vërtetohej pretendimi i tij ankimor. Kërkesa që të dëshmohet përvoja profesionale e punës me kontrata paraprake të punës është kërkesë shumë bazike e cila nuk është parashtruar vetëm për këtë aktivitet por pothuajse në të gjitha aktivitetet tjera të ngjashme të prokurimit. Pra përvoja profesionale e punës nuk mund të dëshmohet ndryshme përveçse me dokumente përkatëse që në rastin konkret është kontrata e punës respektivisht titulli juridik përmes të cilit manifestohet krijimi, zhvillimi dhe/apo përfudimi i një marrëdhënie të punës sipas legjislacionit në fuqi. Nga ky këndvështrim, pretendimi ankimor si i tillë është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit nr. 2 duhet theksuar që nostrifikimi apo barazvlefshmëria e diplomës që është fituar jashtë RKS është mënyrë e vetme për të bërë të besueshme dhe të pranueshme në aspektin juridik atë diplomë brenda institucioneve të RKS. Ky konstatim si i tillë bazohet në UA (MASHT) nr. 16/2016 për parimet dhe procedurat e

njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Përndryshe edhe kjo kërkesë si e tillë bën pjesë në kategorinë e kërkesave më themelore që si e tillë parashtrohet jo vetëm në këtë aktivitet por pothuajse në të gjitha aktivitetet tjera të ngjashme të prokurimit. Nga ky këndvështrim, pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.


Sa i përket pretendimit nr. 3 fillimisht duhet sqaruar se kërkesa për bazën e betonit, asfaltit dhe gurëthyesit nuk kontestohet si kërkesë e domosdoshme për këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimi ankimor kufizohet në faktin që parashtruesi nuk e posedon licensën përkatëse dhe rrjedhimisht aludohet që kërkesa të jetë eventualisht diskriminuuese. Megjithatë kërkesa e dosjes së tenderit është formuluar ashtu që nëse një operator ekonomik nuk e posedon licensën në fjalë, kërkesa do të konsiderohet e pranueshme edhe atëherë kur prezantohet kontratë për furnizim nga një operator tjetër që posedon licensë me validitet së paku deri në përfundim të kontratës. Prandaj pretendimi është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.05.2024


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.